

**Departamenti i Demokratizimit
Seksioni për Pjesëmarrje Publike**

Prishtinë, 23 Mars 2022

**Thirrje e hapur
për
tridhjetë (30) kandidatë për program pesëmujor të punës praktike
Programi i punës praktike në nivel komunal**

Informata të përgjithshme

Pjesëmarrja publike e të rinjve në vendimmarrje garantohet dhe promovohet përmes një kornize gjithëpërfshirëse normative dhe politike që rregullon fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë së Kosovës. Kjo kornizë përfshin Ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, katër udhëzime administrative¹, si dhe Strategjinë për rininë që i përcakton prioritetet dhe synimet për periudhën 2019-2023.

Të rinjtë kanë të drejta dhe mundësi për të kontribuar në vendimmarrje dhe politikëbërje, qoftë drejtpërdrejt ose përmes organeve ekzistuese përfaqësuese si Këshilli Rinor i Kosovës, këshillat e veprimit rinor lokal (KVRL), Këshilli Studentor i Kosovës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

Megjithatë, të rinjtë shpeshherë nuk kanë mundësi që t'i ushtrojnë të drejtat dhe të kontribuojnë në shkallë të plotë në proceset vendimmarrëse për dy arsye: nga njëra anë, të rinjve mund t'u mungojnë ndërgjegjësimi, aftësitë, njohuritë, shkathtësitë teknike dhe përvoja e nevojshme, ndërsa nga ana tjetër mundësitë e ofruara nga institucionet publike për përfshirjen e rinisë në vendimmarrje dhe politikëbërje janë të kufizuara. Si rrjedhojë, të rinjtë dekurajohen dhe/ose përjashtohen nga ushtrimi i së drejtës së tyre për pjesëmarrje dhe izoloohen gradualisht nga sfera e vendimmarrjes.

OSBE promovon pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes përmes një qasjeje të pjesëmarrjes ndërvepruese të bazuar në parimin "të mësosh duke bërë" dhe të pajisjes me shkathtësi e njohuri të përshtatshme e të transferueshme.

Këtë vit, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e pushtetit lokal, OSBE do të mbështesë organizimin e një programi pesëmujor të punës praktike për **30 të rinj të moshës 20 deri në 24 vjeç**. Programi synon që t'i afrojë të rinjtë dhe të rejtat me institucionet e pushtetit lokal dhe t'i angazhojë drejtpërsëdrejti në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes në nivel lokal.

Bazuar në profilet dhe interesat e parashtruesve të aplikimeve dhe duke marrë parasysh nevojat e institucioneve partnere, praktikantët e përzgjedhur do të vendosen nëpër zyra/divizione/drejtori të ndryshme të komunave të Kosovës. Institucionet

¹UA nr. 13/2010 për funksionimin e depos qendrore të MKRS-së; UA nr. 10/2010 për punën vullnetare të të rinjve; UA nr. 12/2010 për arsimin joformal të të rinjve; UA nr. 06/2010 për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore

partnere ftohen të emërojnë si mbikëqyrës zyrtarë publikë me përvojë të cilët/cilat do t'i orientojnë dhe monitorojnë praktikantët gjatë tërë periudhës së praktikës. Gjatë praktikës, pjesëmarrësit do të bashkëveprojnë për së afërmi në një detyrë të përbashkët kërkimore për shqyrtimin e sfidave aktuale dhe formulimin e propozimeve praktike për rritjen e angazhimit të të rinjve në vendimmarrje dhe politikëbërje.

Programit të praktikës do t'i paraprijë një **trajnim fillestar** i organizuar bashkërisht nga OSBE dhe institucionet e pushtetit lokal, në kuadër të të cilit do të paraqiten: (i) fushëveprimi dhe synimet e programit, dhe (ii) mekanizmat lokalë të pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes publike.

Veç kësaj, në shtator 2022 do të organizohet një trajnim i ndërmjetëm për të diskutuar rreth çështjeve të lidhura me pjesëmarrjen publike të të rinjve.

Programi i punës praktike do të përmbyllet në nëntor 2022 me një **konferencë përmbyllëse** të organizuar bashkërisht nga OSBE-ja dhe institucionet e pushtetit lokal, ku praktikantët do të prezantojnë përvojën e tyre si edhe gjetjet kryesore të detyrës së përbashkët kërkimore.

Synimi

OSBE synon t'u mundësojë tridhjetë (30) të rinjve dhe të rejave që të fitojnë përvojë profesionale përkatëse në vendimmarrje dhe politikëbërje përmes një programi pesëmujor të punës praktike në institucione të pushtetit lokal.

Detyrat

Varësisht nga natyra e punës dhe drejtoritë/divizionet/sectorët e pushtetit lokal ku do të caktohen, praktikantët do të kenë mes tjerash për detyrë:

- T'i asistojnë drejtoritë/divizionet/sectorët në:
 - realizimin e rolit të tyre këshillues, përfshirë opinionet dhe komentet mbi propozimet e politikave;
 - përpilimin e raporteve të brendshme dhe të jashtme;
 - kryerjen e proceseve të brendshme të planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit;
 - zbatimin e projektit(eve) dhe nismave;
 - kryerjen e hulumtimeve dhe analizave.
- Të përpilojnë një plan për komunikim të rregullt me mbikëqyrësin/koordinatorin e programit;
- Të kryejnë detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi/koordinatori i programit;
- Të kontribuojnë në një detyrë të përbashkët kërkimore;
- Të marrin pjesë në: (i) trajnimin fillestar, (ii) trajnimin e ndërmjetëm dhe (iii) konferencën përmbyllëse.

Rezultatet e pritshme:

- Plani i punës me një përshkrim të detajuar të detyrave, përgjegjësi dhe rezultateve të pritshme (i përgatitur në koordinim me mbikëqyrësin /koordinatorin e programit);

- Raporti përfundimtar që paraqet përvojën profesionale të fituar, përfshirë angazhimin në proceset e politikave dhe vendimmarrjes;
- Anketa përfundimtare mbi programin e punës praktike;
- Kontributi në detyrën e përbashkët kërkimore.

Treguesit e performancës²

- Praktikanti/ja respekton orarin e punës me kohë të pjeshme, sipas planit të dakorduar të punës;
- Praktikanti/ja merr pjesë në (i) trajnimin fillestar, (ii) trajnimin e ndërmjetëm dhe (iii) konferencën përmblylëse;
- Praktikanti/ja i përmbushë rezultatet e pritshme (p.sh. plani i punës, raporti përfundimtar, anketa përfundimtare dhe kontributi në detyrën e përbashkët kërkimore);
- Praktikanti/ja dëshmon njohuri të shtuar për proceset e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal.

Vendndodhja

Kandidatët e përzgjedhur do të caktohen nëpër institucione të përzgjedhura të pushtetit lokal.

Kohëzgjatja

Programi i punës praktike do të zgjasë pesë muaj (qershor-tetor 2022).

Kandidatët e përzgjedhur duhet të paraqiten në vendet ku do të kryejnë praktikën të paktën 14 ditë pune në muaj për jo më pak se katër orë në ditë³.

Kualifikimet e nevojshme

- Të jetë i/e moshës 20 deri në 24 vjeç me rastin e parashtrimit të aplikimit;
- Të jetë i/e regjistruar në studime universitare në një fushë përkatëse (p.sh. drejtësi, inxhinieri, urbanizëm, shkenca politike, administratë publike, edukim, ekonomi, turizëm, arkitekturë, mirëqenie sociale, gjeodezi, bujqësi, teknologji, TIK etj.);
- Të zotërojë mirë gjuhën angleze në të folur dhe në të shkruar; të zotërojë në nivel të shkëlqyeshëm gjuhën shqipe a serbe, ose të dyja gjuhët, në të folur dhe në të shkruar;
- Të ketë shkathtësi të përdorimit të aplikacioneve të Windows, përfshirë përpunimin e tekstit dhe e-mailin;
- Të dëshmojë vetëdije dhe ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore, si dhe gatishmëri për të punuar si anëtar/e ekipi.

² Mbikëqyrësi në secilin institucion bashkëpunues të pushtetit lokal do të përgatisë një vlerësim të plotë për çdo praktikant bazuar në një model të ofruar nga OSBE.

³ Subjekt i marrëveshjeve të mëpastajme me mbikëqyrësin/koordinatorin e programit në secilin institucion përkatës të pushtetit lokal.

Kualifikimet e dëshirueshme

- Njohuri bazë për mekanizmat e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes publike në nivel lokal;
- Anëtarësi aktuale ose e kaluar në strukturat rinore (p.sh. këshillat e veprimit rinor lokal, qendrat rinore etj.) dhe/ose organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në mënyrë aktive në sektorin e rinisë;
- Të ketë kontribuar si vullnetar/e dhe/ose punonjës/e me të rinjtë në nisma/projekte përkatëse.

Sqarim: OSBE-ja është e përkushtuar ndaj diversitetit dhe gjithëpërfshirjes dhe inkurajon gratë candidate që të aplikojnë në programin e punës praktike. Gjatë programit të punës praktike 2022, përparësi do t'u jepet po ashtu dhe kandidatëve/eve me aftësi të kufizuara të caktuara, kandidatëve/eve nga radhët e komuniteteve joshumicë dhe nga zonat rurale.

Kompensimi i propozuar

- Çdo kandidati/eje të përzgjedhur do t'i jepet si kompensim një shumë e përgjithshme prej 70 € për person/në muaj për mbulimin e shpenzimeve të transportit dhe të jetesës. Kompensimi do të bëhet çdo muaj pas dorëzimit të listave të nënshkuara të paraqitjes në vendin e punës praktike.
- OSBE do të mbulojë shpenzimet e policës së sigurimit individual, që mbulon incidentet e mundshme në vendin e punës gjatë orarit të punës. Kostoja e policës së sigurimit do të rimburohet me pagesën e parë mujore, pas dorëzimit të kontratës së nënshkruar të sigurimit dhe dëftesës së pagesës.

Sqarim: OSBE-ja nuk do të mbulojë asnjë shpenzim tjetër të bërë nga praktikantët.

Dokumentet për aplikim:

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë:

- **CV** (maksimum 1 faqe, në gjuhën angleze, me informata përkatëse për sa u përket kualifikimeve të nevojshme dhe të dëshirueshme);
- **Letër motivimi** (maksimum 1 faqe, në gjuhën angleze, ku përshkruhet interesimi për të marrë pjesë në programin e punës praktike, pritshmëritë si dhe kontributet individuale në program).

Të dy dokumentet duhet të dërgohen në: OMIKApprenticeship2022@osce.org, jo më vonë se 17 Prill 2022.

Në tekstin e emailit, aplikantët duhet të tregojnë vendin e preferuar të detyrës. OSBE do të bëjë përpjekje për t'i përshtatur preferencat e aplikantëve me nevojat e formuluar nga institucionet lokale.

Kandidatët të cilët/cilat i plotësojnë kriteret minimale do të ftohen për t'iu nënshtruar një testi online. Sipas nevojës, OSBE-ja mund t'i ftojë kandidatët për një intervistë plotësuese.

Procesi i përzgjedhjes do të kryhet nga OSBE-ja në bashkëpunim të ngushtë me institucionet partnere lokale.